

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Verdikti për ish-krerët e UÇK-së më 16 shtator, Policia e Kosovës merr masat, paralajmërohen kufizime t ë përkohshme të qarkullimit
ADRESA	https://www.gazetatema.net/rajoni/verdikti-per-ish-kreret-e-uk-se-me-16-shtator-policia-e-kosoves-merr-masa-i586092
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 16:41:57 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 16:40:02 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5ad723b4e656400c2de1dfe8d614da2286a0933dd2b72aa4a44cfebe8d8f9e85
TEKSTI	6c7e213d3ada3fa3714187b81497ac88bd46fdf4646042461eaada82d7960c7f
PAMJA	dbdad08439038eefc0b47e97a60e42eb7d012d676f7fd212778aedc45135bcd4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	0198d1d1294fde6d57c3f2e2bab49f3f4ab9ab3f912221ed4c9f712ffd3c1ec
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	7b2b016d700840f0d00306452beff4854c87a5a9cfd79fec123f45a77e434d02
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/0198d1d1294fde6d57c3f2e2bab49f3f4ab9ab3f912221ed4c9f712ffd3c1ec>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English




ie Verdicti për ish-krerët e UÇK-se më 16 shtator. Policia e Kosovës merr masat, paralajmërohen kufizime të përkohshme të qarkullimit Alarmit i rreme për bombe në një sh fundit

Verdicti për ish-krerët e UÇK-së më 16 shtator, Policia e Kosovës merr masat, paralajmërohen kufizime të përkohshme të qarkullimit



14 Shtator 2026, 18:40Rajoni TEMA



Policia e Kosovës, lidhur me zhvillimet e parapara për datën 16 shtator, ku pritet të merret verdicti përfundimtar i Gjykatës Speciale në Hagë ndaj ish-krerëve të UÇK-së, ka ndërmarrë masat e nevojshme policore për ofrimin e sigurisë, ruajtjen e rendit e qetësisë publike si dhe mbarrëvajtjen e të gjitha aktiviteteve që parashihen.

Në njoftim thuhet se, sipas praktikave të mëhershme të ndërtuara, me qëllim të mirëmbajtjes dhe avancimit të partneritetit, kur pritet të ketë zhvillime, aktivitete apo tubime publike, menaxhmenti i PK-së mban takime informuese dhe koordinuese me drejtorët e departamenteve, divizioneve dhe drejtorët e drejtorive rajonale, përfshirë edhe takime me partnerë ndërkombëtarë, si: KFOR, EULEX, përfaqësues nga Ambasada Amerikane, Zyra e BE-së dhe OSBE-ja.

“Një takim i tillë u mbajt edhe sot në Drejtorinë e Përgjithshme të PK-së, ku u prezantua plani dhe angazhimet policore lidhur me zhvillimet e parapara që ndërlidhen me datën 16 shtator” m thuhet në njoftim.

Më tej thuhet se Policia e Kosovës, sipas detyrës zyrtare dhe legjislacionit në fuqi, do të ofrojë siguri për të gjithë qytetarët pa dallim, si dhe do të angazhohet me njësi policore, në mënyrë që mbarrëvajtja e të gjitha aktiviteteve dhe zhvillimeve të mundshme të kalojnë të qeta dhe pa incidente.

“Varësisht nga aktivitetet dhe zhvillimet e mundshme, mund të ketë kufizime ose ndërprerje të përkohshme të qarkullimit në rrugët e prekura nga aktivitetet, andaj Policia e Kosovës ka parashikuar edhe angazhime të njëjse policore patrulluese të trafikut, në rast të nevojës për riorientim të trafikut në rrugët alternative”, thuhet në komunikatë.

Policia e Kosovës iu bën thirrje qytetarëve dhe pjesëmarrësve që të respektojnë udhëzimet e zyrtarëve policorë, të tregojnë kujdes dhe të kontribuojnë që aktivitetet të zhvillohen në mënyrë të qetë dhe të sigurt, pasi planifikimi dhe ndërmarrja e masave të sigurisë në rastet kur pritet të ketë zhvillime, aktivitete, apo pjesëmarrje të madhe të qytetarëve, hartimi dhe implementimi i planeve policore janë pjesë e procedurave të rregullta policore, që shërbejnë në interes të sigurisë së përgjithshme.

Policia e Kosovës në fund falënderon qytetarët për mirëkuptim dhe bashkëpunim, siguria e qytetarëve dhe mbarrëvajtja e aktivitetit janë prioritet të Policisë së

Kosovës.

“Zyrtarët policorë do të jenë të pranishëm në terren për të garantuar rendin kushtetues dhe sigurinë publike në vend”.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

17:43 Rajoni

Mbrojtja e Hashim Thaçit: Kundërshtojmë të gjitha transkriptet, fajësia nuk mund të mbështetet në to

16:50 Rajoni

Vendimi për ish-krerët e UÇK, Rutte: KFOR-i është aty, pavarësisht ç'mund të ndodhë këtë javë në Kosovë

16:18 Rajoni / 1 koment

SHBA-ja paralajmëron Serbinë për afrimin me Kinën në fushën e IA-së

14:20 Rajoni / 1 koment

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.